




| | |
|---|---|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u> | Nr Prot Br Prot <u>01-120/2013</u> |
| Dep Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u> | Data Datum Date <u>22-01-2013</u> |
| PRISHTINE | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **28.12.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3031/11, për ztr. Hashim Deshishku – Deputet në Kuvendin e Kosovës, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-3031-11, për Zyrtarin e lartë, ztr. Hashim Deshishku – Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në biznese private, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit, konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr. Deshishku, është paraqitur, në takim me zyrtarët e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Hashim Deshishku ka deklaruar se do të filloj procedurat e ndryshimit të kësaj gjendje, konform Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.

Megjense ndryshimet e kerkuara janë bërë vetëm për njein nga bizneset, ndërsa te tjetri (Hib – Construction) këto ndryshime, atë këtë kohë, nuk ishin bërë, atëherë Agjencioni kundër korrupsionit, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarit të lartë i ka dërguar edhe shkresën e dytë (Z.D./DPK-01-31-2012),.

Pas shkresës së dytë nga Agjencia që ndryshe quhet Paralajmërim, zyrtari i lartë, ztr.Deshishku, ka filluar procedurën e shuarjes së tërsishme të biznesit “Hib Construction” Sh.p.k.

Për shkak se paraprakisht kishim të ditur se procedura e shuarjës së biznesit zgjatë më shumë, ne kemi pritur derisa me datë 27.12.2012 nga personi zyrtar na është ofruar dokumenti zyrtar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) me numer protokoli DPK/DPKI-03-4621/12, që dëshmon se ky biznes tashmë është shuar në tërsi, në mënyrë vullnetare.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.


II. Në pajtim me nënin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit


/Hasan Preteni